

Bankat si ndërmjetëse financiare

Dr. Elvin MEKA

2₍₂₎

I. Sistemi bankar shqiptar

Historiku

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Lindja dhe zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri është i lidhur ngushtë me zhvillimet monetare dhe financiare në Perandorinë Osmane dhe në kuadër të të gjithë zhvillimeve ekonomike dhe politike në të gjithë hapësirën shqiptare.

Shfaqja e shërbimeve bankare dhe financiare lidhet ngushtësisht me krijimin e Bankës Perandorake Otomane në 4 shkurt 1863.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri ka kaluar në 7 faza:

1. Përpjekjet për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në 1912.
2. Marrëveshja e Qeverisë së z. Ismail QEMALI për themelimin e Bankës Kombëtare, së bashku me grupet bankare Italiane dhe Austriake, 4 nëntor 1913.
3. Përpjekjet për ngritjen e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në vitet 1913-1925.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Ngritja dhe zhvillimi i sistemit kapitalist në Shqipëri (fillimet e shekullit XIX), fillon më vonë se vendet e tjera të rajonit, duke kushtëzuar zhvillimin në kohë të të gjithë zinxhirit institucional, produkteve dhe shërbimeve financiare.

Gjatë kësaj periudhe shfaqen në ekonomi ndërmarrjet dhe fabrikat e para, duke i hapur kështu rrugën nevojës për banka e kreditim, e rrjedhimisht për ngritjen e një sistemi monetar dhe bankar në Shqipëri.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e parë.

Themelimi i Bankës Perandorake Osmane (1863), si një autoritet emetues lëshimin brenda Perandorisë Osmane.

Banka zgjeron veprimtarinë dhe në territoret shqiptare, duke hapur degë në:

- Shkodër,
- Shkup,
- Manastrir
- Janinë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e parë.

Banka Agrare Turke (1888) hap aktivitetin e saj në disa qytete shqiptare.

Në 1909, Banca Commerciale d'Oriente hapi një degë në Shkodër, nën emrin "Tozzi and Company".

Në 28 nëntor 1912 Shqipëria shpalli pavarësinë e saj si shtet sovran dhe qeveria e re mori masa të veçanta për të krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, së bashku me fuqitë e mëdha.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e dytë.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Banka Kombëtare e Shqipërisë i atribuohet autoriteti i bankës qendrore (emetimi i kartëmonedhave, në gjuhën shqipe dhe franceze, agjent fiskal për qeverinë, tregtimi i bonove të thesarit dhe letrave me vlerë të qeverisë), si dhe aktivitete tregtare, si: pranimi i depozitave, huadhënia tregtare dhe hipotekore, emetimi i obligacioneve të garantuara, etj.

Franga shqiptare u vendos si monedhë zyrtare kombëtare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e tretë.

Klima e trazuar politike, Luftërat Ballkanike dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore kushtëzoi jetëgjatësinë e këtij institucioni.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, disa degë të bankës së Fuqive të Mëdha u hapën, të tilla si: Wiener Bank Verein, Pester Bank and Ungarische Bank. Këto banka shërbyen në financimin e ushtrive të tyre përkatëse në Shqipëri.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e tretë.

Në 1920 emetohet edicioni i parë i obligacioneve qeveritare trevjeçare me vlerë 2 milion franga ari.

Qeveria shqiptare hyn në diskutime me qeverinë italiane për krijimin e bankës së re të shtetit shqiptar si shoqëri aksionere.

Qeveria Shqiptare kërkon ndihmën e Lidhjes së Kombeve për krijimin e bankës kombëtare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e katërt.

Viti 1925 shënon krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë (2 shtator 1925), në Romë, Itali, si një institucion i përbashkët italo-shqiptar, me drejtor italian. Pas krijimit, Selia zhvendoset në Durrës. BKSH u themelua si institucion emetues dhe kreditues.

Gjatë 1925 lindi kartmonedha e re shqiptare, LEK, për nder të Aleksandrit të Madh ("LEKA" - LEK) me emetimin e 5 lekë = 1 frangë ar shqiptar.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e katërt.

Fakti më i rëndësishëm për këtë periudhë ishte se, Franga shqiptare kuotohet rregullisht në bursat ndryshme, si: Vjenë, Zyrih, Milano, Trieste.

Kartëmonedha (në franga shqiptare) gjatë kësaj periudhë ishte plotësisht e mbështetur (garantuar) me ar, dhe kuotohej dhe me lartë se dollari amerikan, duke ndihmuar në tërheqjen nga qarkullimi të monedhave të arit e argjendit.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e katërt.

Gjatë periudhës 1926 - 1936, BKSH hapi gjashtë degë, duke rritur dhe zgjeruar aktivitetin bankar në rajonet kryesore të vendit.

Këtë vit krijohet Banka Agrare, për mbështjen dhe zhvillimin e sektorit bujqësor. Deri në fund të këtij viti, selia e bankës zhvendoset përfundimisht nga Durrësi në Tiranë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e katërt.

Në 1926, hapet "Banka e Athinës", një nga bankat më të fuqishme greke, në Durrës dhe Korçë.

Hapen degët e bankave "Export Bank", me seli në Beograd, në 1934 (në funksion deri në 1939) dhe "Banca di Napoli - Shqipëri", në 1937.

BKSH mbajti monopolin e kredidhënies, duke kufizuar konkurrencën në sektorin bankar shqiptar. Kjo ishte arsyeja për ekzistencën e një numri shumë të kufizuar të bankave tregtare në Shqipëri gjatë kësaj periudhe (4 banka me 17 degë në total).

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e pestë.

Pas pushtimit italian në 1939, një nga masat e para ishte heqja e garancisë së arit për frangën shqiptare dhe zëvendësimi i saj me lira italiane, të garantuara me ar. Heqja e garancisë së arit, për BKSH synonte mbulimin e shpenzimeve të luftës, duke e transformuar sistemin shqiptar monetar dhe të kreditit në një shtojcë e sistemit italian monetar.

Gjatë kësaj periudhe, pati një konkurrencë e ashpër në sektorin e kredisë, si pasojë e ndikimit në rritje të "Banca di Napoli - Albania", dhe hyrjes së "Banca Nazionale del Lavoro".

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e pestë.

Pas pushtimit italian dhe gjerman të Jugosllavisë, autoritetet vendosën zëvendësimin e dinarit jugosllav me frangën shqiptare, në rajonet e banuara nga shqiptarët.

Në 30 tetor 1944, gjermanët vodhën gjithë thesarin shqiptar, që arrinte në 9.500.000 franga ari shqiptare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e gjashtë.

Pas çlirimit dhe vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, në 1945 BKSH shtetëzohet dhe krijohet në 13 janar 1945 Banka e Shtetit Shqiptar (B.SH.SH.), me të dy funksionet si banka qendrore dhe tregtare.

Gjithashtu, B.SH.SH. iu dha autoriteti për rregullimin dhe funksionimin e sistemit të pagesave në Shqipëri. B.SH.SH. ishte praktikisht operatori i vetëm bankar dhe financiar në Shqipëri deri më 1979.

Gjatë 1949-1955, B.SH.SH. Emetoi 4 edicione obligacionesh qeveritare me 20 vjet deri në maturim.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e gjashtë.

Në 1 janar 1979, krijohet Banka Bujqësore, si institucion shtetëror krediti dhe pagesash për kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore.

Pas miratimit të Kushtetutës së re të 1976, B.SH.SH. autorizon shitjen e aksioneve të saj në BIS Bazel, duke u tërhequr nga kjo organizatë ndërkombëtare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e gjashtë.

Viti 1990 shënon shenjat e para të liberalizimit në sistemin financiar shqiptar, duke lejuar fillimin e procesit të kreditimit ndaj sektorit privat në Shqipëri.

Ky liberalizim ishte pjesë e valës së parë të ndryshimeve të rëndësishme në sistemin politik dhe ekonomik në Shqipëri. Gjithashtu në këtë vit, themelohet "Banka Tregtare Shqiptare", për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare dhe operacionet e këmbimit valutor.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Pas ndryshimeve të 1990, vendi hyn në procesin e transformimit nga një ekonomi komuniste në pronësi të shtetit në një ekonomi të tregut të lirë.

Reforma financiare dhe monetare, një nga reformat bazë. Fillon si një reformë institucionale, duke ndryshuar dhe krijuar një kuadër të ri ligjor për sistemin bankar.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Në 1992 krijohet Banka e Shqipërisë (BSH), me atributet e një banke moderne perëndimore qendrore, duke i dhënë jetë krijimit të një sistemi bankar dynivelësh në Shqipëri dhe licencimin e mëvonshëm të katër bankave tregtare:

- Banka Tregtare Shqiptare,
- Banka e Kursimeve,
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka Bujqësore dhe e Zhvillimit.

Këto banka u licencuan parimisht si banka universale, duke synuar të ofronin një gamë të gjerë të shërbimeve bankare dhe financiare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Gjatë 1991 Shqipëria u bë anëtare e FMN dhe Bankës Botërore.

Tranzicion i vështirë; Banka e Shqipërisë përballet me vështirësi të shumta: inflacion i lartë, mungesa kartmonedhash fizike, kontroll i dobët i ofertës së parasë, ekonomi e madhe informale dhe qarkullim i jashtëzakonshëm parash jashtë bankave, etj.

Sistemi bankar shqiptar karakterizohet nga një përqendrim i lartë, ku Banka e Kursimeve zotëronte mbi 75% të gjithë shërbimeve dhe produkteve të sistemit bankar, për shkak të transferimit të të gjitha depozitave bankare familjare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Skemat piramidale informale, me fillesa nga 1992, sfiduan depozitat bankare me norma interesi absurde, duke penguar seriozisht zhvillimin normal të sistemit bankar shqiptar. Ky sistem informal u rrëzua në fund të 1996, dhe u pasua nga trazirat masive civile, të shoqëruara me dëme të konsiderueshme në rrjetin bankar dhe inflacion të lartë (deri 42%). Stabiliteti i sistemit bankar nuk u trondit, por kreditimi u ndërpre për gjithë ekonominë.

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Pas vitit 1997, sistemi bankar hyn në rrugën e zhvillimit normal, rritjes së vazhdueshme, përmirësimit dhe modernizimit të shpejtë.

Periudha 1997-2008 ka parë zhvillime pozitive dramatike dhe revolucionare në sistemin bankar shqiptar, ku u hapën dhe nëntë banka të reja.

Viti 2003 shënoi krijimin e bankës së parë shqiptare: Banka Credins, dhe fundin e kontrollit shtetëror në sektorin bankar, pas privatizimit (100%) të Bankës së Kursimeve, si banka më e madhe në sistem.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Historiku

Faza e shtatë.

Bankat në Shqipëri janë të gjitha në pronësi private, me përjashtim të disa zotërimeve të vogla të shtetit.

Gjatë vitit 2004 dhe 2005 u hap banka e dytë (Banka Popullore) dhe e tretë shqiptare (Union Bank).

II. Arkitektura institucionale e sistemit bankar shqiptar

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Karakteristikat

Sistem bankar universal pa ndarje apo specializim për shërbimet dhe produktet financiare të ofruara.

Sektori dominant brenda sistemit financiar shqiptar:

- aktivet bankare: **93.9 për qind** të totalit të aktiveve të sistemit financiar (T1 2012),
- aktivet bankare: **87.2 për qind** të PBB-së (T1 2012).

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar – Arkitektura institucionale

Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	2007	2008	2009	2010	2011	2012-6M1
Banka e Shqipërisë	Sistemi bankar	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7	87.2
	Institucione jobanka	1.5	1.7	2.2	2.7	2.5	2.5
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.6	0.7	0.8	0.8	0.7	0.7
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.4	1.4	1.5	1.4	1.5	1.5
	Fondet e pensionit	-	-	0.01	0.01	0.01	0.01
	Fonde Investimi						0.86

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2₍₂₎

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Karakteristikat

Sistemi bankar shqiptar përbëhet aktualisht nga 16 banka tregtare (të nivelit të dytë). Deri në fund të 2010, rrjeti bankar shqiptar kishte 434 degë dhe 100 agjenci brenda vendit dhe 1 degë jashtë Shqipërisë.

Tabelë 5. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve.

Nr.	Subjektet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	14	15	16	17	17	16	16	16	16	16
2	Subjekte financiare jobanka	5	7	7	7	6	6	7	13	17	19
3	Zyra të këmbimit valutor	58	58	54	58	60	112	189	221	284	301
4	Shoqëri të kursim-kreditit	113	131	130	131	125	130	133	135	126	126
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Numri i punonjësve	3,479	4,263	5,206	6,404	6,384	6,430	6,714
Numri i njësive (degëve)	250	292	392	517	530	531	535
Numri i punonjësve për:							
- Bankë	217	251	306	400	399	402	420
- Njësi bankare	13	15	13	12	12	12	13
Numri of rezidentëve për:							
- Bankë	184,410	188,235	186,235	200,000	200,000	187,500	176,984
- Njësi bankare	12,539	10,958	8,077	6,190	6,037	5,650	5,303,
- Punonjës banke	901	751	608	500	501	467	422

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Karakteristikat

Kapitali i huaj/kapitali i sistemit: **92.8%** (2011)

Sistem bankar thuajse tërësisht privat.

Grupe të mëdha bankare ndërkombëtare dhe rajonale, prezente në Shqipëri:

- *Raiffeisen Bank (Raiffeisen Zentral Bank),*
- *Intesa Sanpaolo – Albania (Intesa Sanpaolo),*
- *Societe Generale – Albania (Societe Generale),*
- *Credit Agrigole,*
- *NBG Bank,*
- *Alpha Bank,*
- *Tirana Bank (Pireaus group).*

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale


Karakteristikat

Treguesit	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Totali i aktiveve (në mld lekë)	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9	834.1	886.3	990.6	1,120.2
Totali i aktiveve /GDP, %	0.538	0.568	0.609	0.708	0.768	0.767	0.775	0.81	0.8
Totali i kredive/GDP, %	0.073	0.093	0.157	0.224	0.302	0.365	0.393	0.401	0.4

*raportet ndaj PBB mbështeten në vlerësimin paraprak për PBB e vitit 2011.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe komponentëve të saj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregues	Dhjetor'08	Dhjetor'09	Dhjetor'10	Dhjetor'11
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	17.2	16.2	15.4	15.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Karakteristikat

Kartat Elektronike

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Karta Debiti	223,227	343,711	603,384	496,301	543,141	667,548	693,958	719,809
Karta Krediti	2,686	9,754	12,991	15,931	23,844	27,300	37,893	49,173
Totali	225,913	353,465	616,375	512,232	566,985	694,848	731,851	768,982
ATM	205	335	433	642	741	771	805	823
POS	779	1,183	1,776	2,953	4,370	4.903	5,126	5,307

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Karakteristikat

Përqendrim relativisht i lartë i aktivitetit bankar:

3 bankat më të mëdha zotërojnë (T.IV.2011):

- ❑ 57.7 % të aktiveve,
- ❑ 48.69 % të depozitave.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

AKTIVET

Tabela 10. Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar.

Treguesit:	Dhjetor'08		Dhjetor'09			Dhjetor'10			Dhjetor'11		
	Shuma*	Pesha**	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi***	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi***	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi***
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	251.4	30.1	254.3	28.7	1.2	296.2	29.9	16.5	333.2	29.7	12.5
Nga këto:											
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	69.2	8.3	69	7.8	-0.4	82.2	8.3	19.2	91.2	8.1	11.0
- Bono thesari	107	12.8	106.3	12	-0.7	103	10.4	-3.1	104.6	9.3	1.6
- Marrëdhënie me bankat e tjera	55.4	6.6	58	6.5	4.8	91.9	9.3	58.5	117.6	10.5	28.0
2. Veprime me klientët (bruto)	394.1	47.2	446	50.3	13.2	486.5	49.1	9.1	561.7	50.1	15.5
3. Veprime me letrat me vlerë	166.7	20	177.7	20.1	6.6	210.7	21.3	18.5	244.2	21.8	15.9
4. Mjete të tjera	8.4	1	8.2	0.9	-3.5	9.1	0.9	11.7	13.8	1.2	51.6
5. Mjete të qëndrueshme	15.2	1.8	14.7	1.7	-3.2	13.8	1.4	-5.8	13.9	1.2	0.5
Totali i aktiveve	834.1	100	886.3	100	6.3	990.6	100	11.8	1120.2	100.0	13.1

*në miliardë lekë, **në %, ***në %

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

PASIVET

Tabelë 11. Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar.

Treguesit:	Dhjetor'08		Dhjetor'09			Dhjetor'10			Dhjetor'11		
	Shu- ma*	Pe- sha**	Shu- ma*	Pe- sha**	Ndryshi- mi***	Shu- ma*	Pe- sha**	Ndryshi- mi***	Shu- ma*	Pe- sha**	Ndryshi- mi***
1.Veprime me thesarin dhe ndërbankare	98.8	11.8	89.9	10.1	-8.9	61.2	6.2	-31.9	72.1	6.4	17.9
2.Veprime me klientët (bruto)	633.8	76	683.8	77.2	7.9	805	81.3	17.7	911.2	81.3	13.2
3.Detyrime të tjera	9.48	1.1	5.7	0.6	-40.3	7.5	0.8	32.9	10.2	0.9	35.5
4.Burimet e përhershme	80.4	9.6	96	10.8	19.5	104.8	10.6	9.1	113.4	10.1	8.2
Totali i Pasiveve	834.1	100	886.3	100	6.3	990.6	100	11.8	1120.2	100.0	13.1


*në miliardë lekë, **në %, ***në %

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale




Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾


Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Grafik 7.3.2. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave dhe kredive, në muaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.2.1. Ecuria e aktiveve me rrezik, indeks dhjetor 2005=100.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale




Bankat si ndërmjetëse financiare

2₍₂₎

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

a. Leva financiare për sektorin bankar.



Niveli i ulët i levës financiare:

- Financim i lartë me kapital aksioner (2011: leva financiare: 11,56 herë),
- Nivel i ulët borxhi,
- Strukturë e thjeshtë financimi.

Leva financiare	Sistemi bankar
Dhjetor 2009	10.4
Shtator 2009	10.7
Qershor 2009	10.7
Mars 2009	11.2
Dhjetor 2008	11.7
Shtator 2008	12.5
Qershor 2008	12.6
Mars 2008	12.7
Dhjetor 2007	13.1
Dhjetor 2006	14.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat si ndërmjetëse financiare

2⁽²⁾

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Banka e Shqipërisë

Objekivi:

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

Funksionet:

- Bankë emetuese,
- Bankë e bankave,
- Bankë e qeverisë,
- Hartuese dhe zbatuese e politikës monetare,
- Mbikëqyrëse dhe kontrolluese e sistemit bankar,
- Agjent fiskal i qeverisë,
- Administruese e sistemit të pagesave (AIPS, AECH).

Bankat si ndërmjetëse financiare

2₍₂₎

Sistemi bankar shqiptar - Arkitektura institucionale

Banka e Shqipërisë

Pavarësi e kënaqshme institucionale në:

- Vendimmarrje,
- Hartim dhe zbatim politike monetare,
- Mbikëqyrje,
- Prodhim dhe publikim të statistikave kombëtare monetare.